



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË



STUDIO BLETA

Nr. Prot. 871/11.03.2025

Nr. Prot. _____ Vlorë, _____, 2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË

&

STUDIO BLETA

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, si institucion publik me statusin "Person Juridik Publik" përfaqësuar nga Prof. Dr. Aurela Saliaj në cilësinë e Rektorit si përfaqësuesi ligjor për çështjet akademike dhe protokollare dhe autoriteti më i lartë akademik,

&

Studio Bleta, përfaqësuar nga z. Julian Bleta, në cilësinë e Administratorit.

Me qëllim zhvillimin e praktikave profesionale, interesin e përbashkët, duke vlerësuar kontributin e deritanishëm dhe dëshirën e mirë për të konsoliduar bashkëpunimin e përbashkët ndërinstitutional, palët bien dakort të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi(më poshtë "**Marrëveshja**")



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 1 **Qëllimi i marrëveshjes**

Kjo marrëveshje ka për qëllim, bashkëpunimin ndërmjet Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Studio Bleta në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale për studentët e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Neni 2 **Baza ligjore**

Zhvillimi i praktikës mësimore bazohet në ligjin 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, ligji Nr.10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", VKM – së Nr.77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor".

Neni 3 **Mënyra e Bashkëpunimit**

Marrëveshja ka për qëllim bashkëpunimin e ndërsjelltë ndërmjet Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Studio Bleta, duke përfshirë:

- Zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve të UV-së në programet e studimit Bachelor dhe Master.
- Sigurimin e ambienteve të përshtatshme brenda territorit të institucionit për realizimin e seancave mësimore të praktikave profesionale.
- Realizimin e praktikave (mësimore dhe profesionale) të programeve të fushave të ndryshme, të ofruara nga Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për Edukimin në Vazhdimësi (konferenca, simpoziume, trajnime, workshop-e).

Neni 4 **Sfera e bashkëpunimit**

Pjesë e këtij bashkëpunimi do të jenë:

- Njësitë kryesore nga të cilat përbëhet Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.
- Studio Bleta

Ky bashkëpunim përfshin realizimin e programeve mësimore në dy cikle studimi:

- Cikli i parë i studimeve të nivelit Bachelor
- Cikli i dytë i studimeve të nivelit Master

Palët nënshkruese do të bashkëpunojnë në këto fusha:

- Leksionet dhe seminarët në module mësimore të caktuara.



- Praktikat mësimore
- Praktikat profesionale
- Detyrat e kursit dhe Tema Diplomash.

Neni 5 Detyrimet e palëve

1. Studio Bleta, merr përsipër:

- 1.1 Lejimin e studentëve të UV-së, për të zhvilluar praktikën mësimore pranë këtij institucioni.
- 1.2 Krijimin e kushteve për kryerjen e aktiviteteve të përcaktuara në nenin 4(katër) të kësaj marrëveshjeje, që do të ndërmeren nga ana e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- 1.3 Caktimin e një personi përgjegjës për zhvillimin e praktikës mësimore i cili do të bëjë orientimin, mbikqyrjen, mentorimin e studentëve gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të praktikës mësimore.
- 1.4 Raportimin pranë Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë nëse do të ketë problematika të ndryshme që mund të jenë krijuar nga ana e studentëve të hasura gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës mësimore.

2. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, merr përsipër:

- 2.1 Dorëzimin, (para fillimit të praktikës mësimore), pranë çdo Institucioni, të listës emërore (firmosur nga Drejtuesi i Njesisë Bazë) të studentëve që do të zhvillojnë praktikën mësimore.
 - 2.2 Depozitimin pranë çdo Institucioni të dokumentit justifikues ligjor në lidhje me derdhjen e kontributeve për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale të të gjithë studentëve që do të zhvillojnë praktikën mësimore për të gjithë periudhën e praktikës mësimore, në zbatim të VKM – së Nr.77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor".
 - 2.3 Orientimin e studentëve në lidhje me respektimin e rregullave të secilit Institucion.
- 3 Palët kanë detyrimin të mbrojnë të dhënat personale që përpunohen dhe në mënyrë të veçantë për të dhënat sensitive, në përputhje me ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008, i ndryshuar "Për mbrojtjen e të dhënave personale".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 6 **Respektimi i marrëveshjes**

Institucionet bien dakord që, nëse për arsye grevash, ose mosmarrëveshjes të punës, motit të keq, "Fuqisë Madhore" ose shkaqeve të tjera objektive të cilat janë të pashmangshme, shkaktuar përtej mundësisë që kanë ato për t'i kontrolluar, në mbështetje të këtij paragrafi, nëse institucionet nuk janë të afta të kryejnë detyrimet e tyre, kjo pamundësi e tyre nuk do të konsiderohet si prishje e Marrëveshjes.

Neni 7 **Mirëbesimi**

1. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë dhe Studio Bleta do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.
2. Palët duhet të rruajnë dhe të administrojnë me mirëbesim të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 8 **Afati i marrëveshjes**

1. Kjo marrëveshje do të lidhet për një kohëzgjatje 5(pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit
2. Pas përfundimit të datës së përcaktuar në paragrafin e mësipërm, kjo marrëveshje mund të zgjatet bazuar në një marrëveshje të përbashkët me shkrim.
3. Marrëveshja mund të zgjidhet nga secila Palë, nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës tjetër, të paktën 6(gjashtë) muaj përpara.

Neni 9 **Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Kjo marrëveshje është hartuar në 3(tre) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga 1(një) kopje do të depozitohen në Rektoratin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Njësinë Kryesore, 1(një) kopje do të depozitohet në Studio Bleta.

PËR

UNIVERSITETIN
"ISMAIL QEMALI" VLORE

REKTOR
PROF. DR. AURELA SALIAJ

PËR

STUDIO BLETA

ADMINISTRATOR
JULIAN BLETA

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al